



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.222/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsisë në ditën e votimit, në Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHEN TË BAZUARA ankesat ZL.Anr.222/2025 e datës 15.10.2025 dhe ZL.Anr.223/2025 e datës 15.10.2025, të parashtruara nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Kamenicë, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që fletëvotimet në vendvotimin-kutia e votimit Nr.1019/01, dhe 1020/01 në Kamenicë të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Më datë 15.10.2025, PZAP-i ka pranuar dy ankesa të cilat mbajnë numër ZL.Anr.222/2025 dhe ZL.Anr.223/2025, të paraqitura nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në të cilat pretendohet se ditën e zgjedhjeve Komunën e Kamenicës, në vendvotimin 1020-01, sipas raportit të QNR-së, rezulton se janë regjistruar 354 nënshkrime të vendvotuesve, ndërsa në kutinë e votimit janë gjetur 353 fletëvotime, si dhe në vendvotimin 1019-01, sipas raportit të QNR-së, rezulton se janë regjistruar 371 nënshkrime të votuesve, ndërsa në kutinë e votimit janë gjetur 372 fletëvotime, që rezulton në një fletëvotim më shumë se numri i votuesve që kanë nënshkruar në listën përkatëse. Kanë theksuar se kjo situatë vë në pikëpyetje besueshmërinë e rezultatit zgjedhor në atë vendvotim, dhe kanë kërkuar nga PZAP që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ti kthej në rivotim vendvotimin 1019-01 si 1020-01, në Komunën e Kamenicës.

Në përgjigjen në ankesë KQZ kanë deklaruar se pas pranimit të kërkesës për përgjigje së PZAP ka kontaktuar me KKZ e Komunës së Kamenicës, të cilët kanë deklaruar se sipas të dhënave të evidentuara në Librin e Votimit të Këshillit të Vendvotimit (KVV), në vendvotimin 1020/01 kanë deklaruar se gjatë numërimit të nënshkrimeve në listën e votuesve, dhe gjatë procesit të votimit është hedhur një nënshkrim më tepër gabimisht dhe nuk është numëruar në numrin e fletëvotimeve të përdorura, ndërsa sa i përket vendvotimit 1019/01, numri i nënshkrimeve në listën e votuesve është 371, numri i fletëvotimeve të papërdorura është 228 dhe numri i fletëvotimeve brenda në kuti të votimit është 372, se procesi zgjedhor ka shkuar në mënyre korrekte.

Si provë KQZ ka bashkëngjitur përgjigjen e KKZ të Komunës së Kamenicës, Librin e evidencës nga QKN, Librin e votimit për vendvotimin 1020/01 dhe 1019/01 dhe formularët digjital për ato vendvotime.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar dy ankesat e datës 15.10.2025, të paraqitura nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AKK), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.Anr.222/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesat janë të bazuara.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik AAK me të cilat pretendon se ka pasur mospërputhje mes listës së nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutinë e votimit, se ka qenë nga një votim më pas në kutinë e votimit për dallim nga lista e nënshkrimeve në fletëvotimet 1019/01 dhe 1020/01, në Komunën e Kamenicës, paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit janë vërtetuar të gjitha këto pretendime, se ka mospërputhje mes listës së nënshkrimeve të votuesve dhe fletëvotimeve në kuti të votimit.

Nga hetimi i kryer nga ana e ekipit hetues të PZAP-it, me datën 17.10.2025 është konstatuar kjo gjendje faktike: në vendvotimin 1019/01, kanë qenë 371 nënshkrime në Listën e Votuesve dhe 372 fletëvotime në kutinë e votimit, ndërsa në vendvotimin 1020/01, numri i nënshkrimeve në Listën e Votuesve ka qenë 354, ndërsa numri fletëvotimeve brenda në kutin të votimit ka qenë 353. Po ashtu, Pzap-i gjatë hetimeve të kryera ka konstatuar se në vendvotimin 1019/01 po ashtu kanë qenë 228- fletëvotime të papërdorura; 0- fletëvotime të dëmtuara/të pavlefshme, 24- numri i fletëvotimeve të zbrazëta/të pavlefshme (brenda kutisë).

Në vendvotimin 1020/01 kanë qenë: 345-fletëvotime të përdorura; 2- fletëvotime të dëmtuar gjatë ditës; 26- numri i fletëvotimeve të zbrazëta/të pavlefshme (brenda kutisë).

Andaj nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në vendvotimin 1019/01 prej 371 nënshkrimeve në Listën e Votuesve, në kutinë e votimit janë gjetur 372 fletëvotime, dhe në vendvotimin 1020/01 prej 354 nënshkrimeve në Listën e Votuesve, në kutinë e votimit janë gjetur 353.

Në bazë të lartcekurave paneli vlerëson se në vendvotimin 1019/01 është një (1) fletëvotim më shumë se në listën e nënshkrimeve, ndërsa në vendvotimin 1020/01 është një (1) nënshkrim më shumë në listën e nënshkrimeve në krahasim më numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit, të cilat janë në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 105 i LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht thotë *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”,* si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13 *“në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme: 12.1. të urdhëroje KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi.”*

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, konstaton se në fletëvotimet 1019/01 dhe 1020/01 ka pasur mospërputhje mes numrit të nënshkrimeve në Listën e Votuesve dhe numrit të fletëvotimeve në kutinë e votimit, përkatësisht se në vendvotimin 1019/01 ka qenë një nënshkrim më pak në Listën e Votuesve në krahasim me kutinë e fletëvotimit, dhe në vendvotimin 1020/01 është një nënshkrim më shumë në Listën e Votuesve në krahasim më kutinë e votimit.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 105 , neni 118 par. 1 të LZP-së Nr.08/L-228, lidhur me nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.222/2025, datë 17.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.